

URDHËR
Nr. 117, datë 7.5.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 12, pikat 1 dhe 13, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 7, pika 3, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetutës”, e ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:

a) nënshkrim kërkesë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, për tërheqjen e dokumentacionit që ka kërkuar kryesuesja e çështjes për heqjen dorë të anëtares së trupit gjykues znj. Natasha Mulaj nga shqyrtimi i çështjes (JR) nr. 34/2018, datë 13.11.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Malaj, sipas ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik dhe përcjelljen e këtij dokumentacioni pas evidencimit nga protokoli i Kolegjit të kryesuesja e çështjes;

2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është vetëm sipas pikës 1, germa “a”, të këtij urdhri.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.

4. Z. Luan Daci nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Natasha Mulaj